

ETNOGRAFIA E TË FOLMES SË REKËS SË EPËRME

Abstrakt

Ana kuptimore e leksemave të etnokulturës në gjuhësi merr vlera të treguesit, i cili shfaqet jo vetëm si emërtues, por edhe në një funksion më të gjerë, në sferën e së ashtuquajturës etnosemantikë ose në “kuptimin kulturor”, që është trajtuar edhe në antropologjinë e gjuhës apo në etnografinë e të folurit. Nisur nga kjo premisë, leksemat e etnokulturës brenda vetes tregojnë mbi aspekte të shumta jo vetëm të gjuhës e të dialektit, por edhe atë të kulturës. Nga ky këndvështrim ato i nënshtrohen interesit brenda taksonomisë popullore. Kjo taksonomi e gjuhës popullore është e gjerë sa i përket përdorimit të leksemave, përmes së cilave shpaloset botëkuptimi, konceptet fetare dhe kulturore të një populli. Në këtë kontekst, tema përqendrohet në shumë sfera të etnologjisë dhe të ndërlidhjes së saj me gjuhën. Qëllimi është që të analizojmë aspektin religjioz e kulturor, si ndikojnë në rrafshin kuptimor të leksemave të caktuara dhe, për këtë arsye, kemi përfshirë të folmen e Rekës së Epërme dhe të viseve të tjera ku banorët janë shpërngulur. Duhet pasur parasysh ndasitë e religjioneve të ndryshme, ortodokse dhe myslimane, që ndikojnë edhe në pjesë të gjuhës dhe leksikut të kësaj të folmeje shqip, të cilat dëshmojnë për rrënjët e përbashkëta dhe trashëgiminë e bartur, jo vetëm materiale, por edhe atë shpirtërore.

Pa dashur të kthehemi në interpretimet e opinionit të pjesës dërmuese shkencore sllave, duhet pasur parasysh se ky rajon dhe e folmja e tij kanë qenë objekt i spekulimeve të ndryshme. Ideja është të regjistrojmë këto etnoleksema, sidomos ato që përdorin ortodoksët në Maqedoninë e Veriut pasi, si në shumë të folme të tjera, do të kalojnë në leksikun e humbur.

Fjalë kyçe: leksema, leksema të etnokulturës, etnosemantikë, e folmja e Rekës, kalendari popullor, cikle të lindjes, të martesës, të vdekjes

Abstract

The semantic meaning of the lexemes of ethnoculture in linguistics, takes the values of the indicator, which appears not only as a denominator, but also in a wider function, in the sphere of the so-called ethnosemantic or in the “cultural meaning”, which is also treated in the anthropology of language or the ethnography of speech. Based on this premise, the lexemes of ethnoculture within themselves point to the many aspects not only of language and of dialect, but also that of culture, and from this point of view becomes an issue of interest within the popular taxonomy. This taxonomy of the peoples language is broad in terms of the use of lexemes through which are revealed worldviews, religious and cultural concepts of a people. In this context, the topic focuses on the area of ethnology and its relationship with language. The aim is to analyze the religious and cultural aspects, how they affect the semantic plane of certain lexemes focusing directly on the dialect of Reka e Epërme (Upper Reka) and other areas where they have moved. The different religions, Orthodox and Muslim, should be taken into account. They affect language and lexicon and also testify to the common roots and the transmitted heritage material as well as spiritual.

Having no intention to turn to the interpretations from the majority of Slavic scientific opinion, it is important to keep in mind that this region and its dialect has been the subject of various speculations. The idea is however to record these ethnolexemes, especially those used by the Orthodox in Northern Macedonia because otherwise, they will pass into the lost lexicon.

Keywords: lexemes, lexemes of ethnoculture, ethnosemantics, the dialect of Reka, the peoples calendar, cycles of birth, marriage, death

1. Gjeografia etnografike e Rekës së Epërme

Reka e Epërme i takon krahinës gjeografike-etnografike të Rekës në Maqedoninë e Veriut. Ajo kufizohet në veri me Kosovën dhe në perëndim me Shqipërinë. Është zonë malore, e vendosur në pjesën veriore të pellgut të lumit Radikë, që vazhdon në Rekën e Poshtme dhe shkon deri në jug, në afërsi të krahinës së Rekës së Vogël. Kufijtë veriorë dhe verilindorë

territorialë të Rekës së Epërme përbëhen prej malit Vracë (i cili është pjesë e malit Sharr), si dhe malit Niçpur me majën Lerë. Kufijtë veriperëndimorë dhe perëndimorë të Rekës së Epërme shkojnë përgjatë maleve të Korabit me majën Korabi i Madh (në lartësi prej 2753 m). Përgjatë rrjedhës së lumit Radika shtrihen fshatrat shqiptare: Tanushë, Grekaj, Nivisht, Rimnicë, Bibaj, Nistrovë, Zhuzhnjë, Sencë, Vallkavi, Belçicë, Va, Niçpur, Krakarnicë, Kiçnicë, Bogdë dhe Vërbjanë.

Kjo krahinë shqipfolëse historikisht ka pasur popullatë të përzier fetare, myslimane dhe ortodokse, që ka ndikuar edhe në përcaktimin e identitetit kombëtar të tyre, duke i ndarë në myslimanë shqiptarë dhe në ortodoksë maqedonas. Duke folur një gjuhë, duke pasur një veshje dhe duke festuar zakone e festa të njëjta, përkatësia fetare është edhe elementi i vetëm i dallimit. Mbështetur në të dhëna terreni, ky rajon, nën presionet e ndryshme historike, ka lëvizur, duke lënë pas fshatrat e tyre dhe duke u shpërndarë nëpër shumë fshatra të tjera që nuk i takojnë krahinës së Rekës. Pjesa më e madhe e tyre janë përqendruar në Gostivar. Mirëpo, në derdhjen e lumit Markova-Rekë dhe e shtrirë përgjatë lumit Patishka-Rekë, në fshatin Patishkë të rajonit të quajtur Karshiakë (35 km larg Shkupit), gjejmë një pjesë të mirë të emrave të Rekës së Epërme, të shpërndara në mëhalla, si: Niçpur, Xhavde, Zhula, Gotkallar, Sencallar, Gegallar (të ardhur nga fshati Grekaj), Gushallar dhe Zhuzhnja (Трифуноски 1958, 186). Këta, zakonisht, veten e quajnë *rekali*, ashtu si i quajnë edhe të tjerët, me idenë e deklarimit se janë nga Reka. Nuk i dimë arsyet e as periudhën saktësisht se kur janë larguar një pjesë e mirë nga Reka e Epërme në Patishkë¹, por ajo që dihet është se në fshat kanë jetuar bashkërisht edhe myslimanët edhe ortodoksët dhe këtë e thonë edhe hulumtuesit serbë, duke pasur parasysh se hulumtimet më të hershme vijnë nga ky grup i etnologëve. Kështu, njëri nga ata që hulumtoi krahinën e Mavrovës nga aspekti etnografik në vitin 1914

¹ Trifunovski pretendon që kjo shpërngulje ka ndodhur nga fundi i shek. XIX, edhe pse nuk ka të dhëna konkrete për të dëshmuar këtë mendim. Vetëm për një nga fshatrat e Rekës së Epërme është e dokumentuar koha e largimit, e kjo ka ndodhur pas djegies së fshatit Shtirovicë nga ana e bullgarëve për arsye të kryengritjes në vitin 1916. Т. Смиљанић, Насеља и порекло становништа, “Мијаци, Горна Река и Мавроско Поље”, Београд, 1925, f. 78.

është Toma Smilaniq², ndërsa, Milenko Filipoviq³ zhvilloi hulumtime etnografike në fushëgropën e Shkupit, ku rëndësi i jep fshatit Patishkë me idenë se do të vërtetojë tezën se ortodoksët nuk janë shqiptarë, por janë serbë.

Të dhëna etnografike, të hershme dhe të rëndësishme, për Rekën e Epërme vijnë nga Franz Baron Nopcsa dhe Bajazit Elmaz Doda në veprën *Jeta e fshatarëve shqiptarë në grykën e Rekës së Epërme, Dibra e Madhe (Maqedoni)*⁴. Duke qenë që Bajaziti vinte nga fshati Nistrovë i Rekës së Epërme, shkroi kujtimet e tij për jetën që zhvillohej në këtë vend. Të dhënat mbi Nistrovën i verifikova edhe nga një grua ortodokse, Lepa Spasenovska, e cila flet gjuhën shqipe me leksema dhe shprehje arkaike të veçanta, posaçërisht në sferën fetare ortodokse, që për pjesën myslimane nuk janë dhe aq të njohura.

Për të plotësuar tablonë etnografike të Rekës së Epërme, krahasimet në të dhëna jepen edhe nga hulumtimi disavjeçar i fshatit Patishkë, i cili brenda vetes ka ruajtur shumë mirë të folmen e Rekës. Sistemi i veçantë fonetik dhe leksematik e bën atë të ndryshojë nga të folmet e tjera gege. Po ashtu, kjo popullatë ka ruajtur edhe ritet e cikleve edhe atë të festave kalendarike, këngët e festave, urimet dhe mallkimet. Ka ruajtur edhe pjesën mitologjike apo atë të rrëfimeve, që, zakonisht, lidhet me dy toponimet, lumin e Radikës dhe Korabin.

2. Koncepti etnolinguistikë dhe leksemat kulturore në të folmen e Rekës së Epërme

Në gramatikat standarde të gjuhës shqipe, *ffjala* përkufizohet si njësi, e cila në fushë të leksikografisë, po ashtu, përkufizohet si *leksemë*. Por, përveç

² Смиљанић, Тома. Насеља и порекло становништа, “Мијаци, Горна Река и Мавроско Поље”, Српски Етнографски Зборник, књ. XXXV, Београд, 1925.

³ Миленко Филиповић, Патишка, Јужни преглед, бр. 4, Скопје, 1931, 163-174.

⁴ Të dhënat për Bajazit Elmaz Dodën (1888-1933) dëshmojnë se dorëshkrimin e ka dorëzuar në Vjenë në prill të vitit 1914, por që është botuar në Vjenë në vitin 2007. (Në gjuhën shqipe: Bajazid E. Doda në bashkëpunim me Franz Baron Nopcsa. 2015. *Jeta e fshatarëve shqiptarë në grykën e Rekës së Epërme, Dibra e Madhe (Maqedoni)*, shqipëruar nga Nexhat Mehmedi dhe Ismail Murati. Koçani: Evropa 92).

përkufizimit si formë dhe funksionit emërtues, ajo ka një kuptim më të gjerë nga e cila dalin edhe leksemat e etnokulturës⁵, që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me emërtime, të cilat shfaqen në të konceptuarit e çështjeve të etnologjisë, ku nga aty dalin fjalë të shumta të lidhura me frymën e mendimit popullor dhe të jetës së tyre. Leksema bëhet njësi e rëndësishme edhe për disiplinat e tjera, ku kuptimi zgjerohet. Kështu “elementi thelbësor është fjala dhe kuptimi i saj gjendet në taksonominë popullore që e njeh si etnosemantikë ose “kuptime kulturore. “Fjalët dhe kategoritë e fjalëve që një gjuhë i përdor janë të lidhura në mënyrë intime me mjedisin jetësor, shikimin mbi botën dhe sistemin kulturor të shoqërisë që e përdorë gjuhën” (Park 2012, 297). Ndaj, ka rëndësi konteksti etnokulturor i leksemave, i cili qëndron në lidhje të ngushtë me kulturën popullore. Kjo pasi “fjalët dhe kategoritë e fjalëve që një gjuhë i përdor janë të lidhura në mënyrë intime me mjedisin jetësor, shikimin mbi botën dhe sistemin kulturor të shoqërisë që e përdorë gjuhën”. (Ibid.) Përkufizimi i tillë i kuptimësisë së fjalëve dhe përdorimi brenda një fushe tematike, shfaqet tek objekti i ligjërimit popullor, të cilin e gjejmë edhe sot e kësaj dite, por që realisht është në rrezik për t’u zhdukur. Çështjet e etnologjisë dhe ndryshimet në mënyrën e jetës brenda shoqërisë shqiptare, çojnë drejt asaj që, edhe leksemat që shënojnë rite e zakone, me mospraktikimin e tyre të zhduken përgjithmonë. Në këtë kontekst, hulumtimi i leksikografisë dialektore ndihmon në krijimin e koncepteve të mbështetura, jo vetëm të gjuhësisë shqiptare, por edhe më gjerë. Në Maqedoninë e Veriut bëhen hapat e parë të studimit dialektor në mikrosistem, duke u përkufizuar brenda një rajoni gjeografik. Mirëpo, hendeuku i krijuar nga aspekti fetar ka ndikuar edhe në të folmet shqip të Maqedonisë. Nga e gjithë kjo gjendje, një nga rajonet më të diskutuara është ai i Rekës së Epërme, që shtrihet rrëzë malit Korab. Arsyeja kryesore është gjuha shqipe, që flitet njëloj nga ortodoksët e myslimanët e këtij regjioni e që, si të tillë, e bartin edhe nëpër fshatrat ku ata historikisht janë shpërngulur. Kjo gjë ka shkaktuar shumë diskutime në opinionin shkencor

⁵ Si njësi e përshkrimit etnolinguistik propozohet emërtimi *kulturem*, që është analoge me termat *fonemë*, *morfemë*, e të tjera të ngjashme dhe diskutohet për përdorimin. I jam referuar Nagórko 2004, 131-143.

të kohës, duke i përcaktuar ortodoksët shqipfolës si sllavë⁶ dhe ata myslimanë si shqiptarë. Kjo e folme shqipe është bërë çështje me interes edhe për albanologët e huaj, siç është Norbert Jokli, i cili në librin e tij *Studime historiko-krabasuese për gjuhën shqipe*, mbështetet pikërisht te leksemat që fliten në Rekë të Epërme për të hedhur poshtë tezat e asimilimit, më saktësisht të “shqiptarizimit” të sllavëve që, për vite të tëra, është promovuar nga rrethet e disa studiuesve dhe hulumtuesve sllavë, në veçanti ata serbë.⁷ Idenë e antitezës se bëhet fjalë për “përkatësinë etnike autoktone shqiptare” të fjalëve e përkrah edhe Franz Nopcsa dhe Bajazid Doda, të cilët, po ashtu, mbështeten në leksikun e të folmes së Rekës: “Po të ishte se rekanët janë sllavë të shqiptarizuar, që do të thotë sllavë, të cilët nën ndikimin e kulturës pozitive ose negative janë shqiptarizuar, atëherë grupet e fjalëve sllave do të kishin ruajtur formën primitive dhe, në të kundërtën, fjalët e grupeve kulturore (fjalët e reja) do të ishin në shqip, gjë kjo që dëshmon qartë përkatësinë etnike autoktone shqiptare” (Doda dhe Nopcsa 2015, 178).

E folmja e Rekës së Epërme, si e folme e gegërishtes verilindore, me veçantitë e sistemit fonetik dallohet nga të folmet e tjera shqipe, sidomos nga aspekti leksikografik, ku janë ruajtur edhe disa nga format më të vjetra të përdorimit gjuhësor në shumë rrafshë. Leksemat e etnokulturës janë të ruajtura mirë, duke mbajtur gjallë ritet e zakonet, që kanë përbërë pjesën kryesore të jetës së tyre e që janë bartur nëpër kohë. Duke qenë që popullata e këtij regionit ka qenë e përkatësive të ndryshme fetare, ortodokse dhe

⁶ Përcaktimi *sllave* është më përmbledhës, pasi, varësisht nga periudhat, kjo përkatësi ka ndryshuar në bullgare, serbe, maqedonase.

⁷ “Në përgjithësi S. mbështetet këtu në punimet më të vjetra, më të reja dhe të fundit, si ato të Hahn-it, Seiner-it, Mladenov-it, Milosavlejič-it (*Južni Pregled* IV/2, Skoplje 1929). Me këto vrojtme etnografike -gjeografike gjuhësore lidhen parashtrime historike lidhur me çastin e shfaqjes së parë të shqiptarëve në Maqedoni. Një paraqitje veçanërisht e hollësishme i kushtohet rrjedhës historike të shqiptarizimit të të dy krahinave maqedonase. Së pari është Reka e Epërme, e folmja sllave e dikurshme e së cilës karakterizohet si e Maqedonisë Perëndimore. Materiali për paraqitjen e konkluzioneve është marrë nga vepra e Smiljanič-it “Mijaci, Gorna Reka i Mavrovsko Polje” (“Naselje i poreklo stanovništva” 20 e Cvijič-it)”. Iniciali S. shënon emrin e sllavistit rus A. M. Seliščevit. (Jokli 2017, 317).

myslimane, ata kanë bashkëjetuar duke festuar bashkë festat e kalendarit popullor, të cilat, edhe pse pagane, janë trajtuar si rite të ortodoksisë. Mirëpo, gjurmë dhe elemente pagane gjejmë tek të dy besimet fetare.

Në vazhdim do të shqyrtojmë disa nga leksemat që dalin nga ritet e ciklet jetësore.

2. 1. Leksema të festave të kalendarit popullor

Kalendari i festave është ai që është praktikuar nga lashtësia, duke organizuar jetën sipas festave pagane, të cilat me kalimin e kohës janë përvetësuar, duke u dhënë përkatësi ortodokse. Problemi, në të cilin janë përfshirë një pjesë e mirë e gjuhëtarëve, qëndron në emërtimet sllave për pjesën më të madhe të festave, që për këto qarqe ka qenë argument i promovimit të tezës së “sllavëve të shqiptarizuar”. Petar Skok-u është njëri nga studiuesit, i cili flet mbi emërtimet sllave të festave, që janë festuar nga shumica e njerëzve të përkatësisë myslimane në regionin e rrethit të Shkupit, dhe, duke u përqendruar në fshatin rekas Patishkë dhe në të folmen e tyre, ai thotë: “Megjithëse shqiptarët janë muslimanë, në kalendarin e tyre popullor ata megjithatë përdorin emërtime shenjëtarësh kristiane sa herë që duhet të përcaktohet data e punëve të ndryshme të fushës. Kështu kohën për punë të fushës e përcaktojnë sipas *Blagaveshtit*, *Shindërdit*, *Shmitrit*” (Skok 1978, 83). Nga kjo nxjerr përfundimin se dy emërtimet e fundit janë thjesht shqiptare - të krishtera, ndërsa i pari është huazuar nga serbo-maqedonishtja⁸. Teza e Skok-ut del e pasaktë, sepse, për festën e *Bllagovec*/ *Bllagoec*/ *Bllagavest*, në të folmen e Rekës kanë emërtimin shqip: *Ungjëllizmi i Hyjlindëses Mari*⁹, por që nuk është ruajtur në të folmen e Patishkës, duke marrë parasysh përkatësinë myslimane të shumicës, ata e përdorin emërtimin *Bllagavest*. Ndërkaq, Doda e jep emërtimin e shkurtër, duke i marrë këto festa fetare si dëshmi të bashkëjetesës së dy religjioneve

⁸ “Është e qartë se dy emërtimet e krishtera të fundit i kanë sjellë nga atdheu i tyre. Këto emërtime janë të kohës kur ende nuk ishin muslimanë. Shprehjen e parë (*Bllagavesht*) e kanë huazuar në visin e ri”(Skok, Petar 1978, 83).

⁹ Elsie, Robert. “Tabllo e një jete të zhdukur”, *Shkoder.net*, konsultuar për herë të fundit më 13 tetor 2020, <https://shkoder.net/fjala/2007/relsie.htm>

(muhamedanë dhe ortodoksë): “Si festa të radhës së dytë llogariten, Shën Nikolla (Sh’nkolli), Shën Maria (Bllagavesti).” (Doda dhe Nopcsa 2015, 60).

Në ligjërimin popullor ortodoks, folësit paralelisht përdorin emërtimet sllave dhe shqipe, që tregon se e njohin fare mirë sferën e festave kalendarike edhe në gjuhën shqipe. Përdorin emërtimet si: Pashkë, por edhe: “Shën Kryqe për Kërstovdenin (sllav.) Për Kryqe (Shynkrysh)” (Doda dhe Nopcsa 2015, 60); Vadica mbas Këshndelle, apo edhe leksemat e tjera, si: kreshmë, ajazmë etj.¹⁰

Emërtimi tjetër i kalendarit popullor *verxbilia/vigjilje* është një formë e mëhershme, e cila në të folme është ruajtur, duke pësuar ndryshime fonetike, por ka ndodhur edhe bartje në aspekt të përdorimit. Në Patishkë, rekasit e kanë ruajtur këtë leksemë, duke shënuar një ditë para festës kalendarike të Shëngjergjit, *Verxbilla*¹¹. Mirëpo, ky emërtim në Rekë nuk përdoret më. Ka ndodhur një lëvizje dhe bartje e kuptimit të leksemës *vigjilje/vergjile* dhe përdoret në kuptim të shënimit të një dite para festës së Bajramit, gjë që e shënon edhe Bajazid Doda, (*Vërgjilles së Bajramit*). Sipas Dodës, arsyet për largimin e këtij emërtimi vijnë nga hoxha i fshatit, “i cili preferon që ditës në fjalë (*Vërgjilles*) t’i thuhet “Arifja e Bajramit” (Doda dhe Nopcsa 2015, 61). Në kuadër të këtyre emërtimeve, që janë fetare dhe turke, shfaqen pasaktësi. Kështu, në shënimet e Dodës jepet emërtimi *Sheser Bajrami* (Doda dhe Nopcsa 2015, 61) ndërkohë që emërtimi i saktë është *Sheker Bajrami*, që në gjuhën turke përdoret për Bajramin e Madh.¹²

¹⁰ Intervistë me Lepa Mlladenovska Spasenovskën, e lindur më 1933 në fshatin Nistrovë – Rekë e Epërme.

¹¹ “Nga analiza e tërësishme e sistemit të bashkëtingëlloreve të së folmes në fjalë, erdhëm në përfundimin se dallimi kryesor ndërmjet të folmeve të fshatrave të Rekë qëndron në praninë e dy bashkëtingëlloreve, përkatësisht të alofoneve (variante të fonemave) që shqiptohen si qiellzore shtegore (spirante) (š) (ž), të cilat janë përfituar nga spirantizimi i mesgjuhorëve të mbarë shqipes (q) dhe (g)”. Për më shumë shih: Sinani 2020, 74-88.

¹² Şeker bayramı – turq. Ky emërtim nuk ka aq përdorim të gjerë në të folmen popullore. Emërtimi më i shpeshtë është Bajrami i Madh edhe festa e Kurban Bajramit, në të folmen shqipe emërohet si Bajrami i Vogël.

2. 2. Leksema të ciklit të lindjes

Përveç ndasive fetare dhe etnike, të cilat ndikojnë edhe në gjuhë, disa nga temat zakonisht lidhen me *gjuhën e grave*. Ato kanë të bëjnë me shprehje dhe emërtime të procesit të shtatzënisë deri në lindje, të cilat i kanë konsideruar si tema tabu. Kështu, për fjalën shtatzënë përdorin shprehjen “e rond”. Gruaja e intervistuar, Lepa Spasenovska, jep një situatë dhe shprehet:

“I thom uni gjë: A e kie nusen me bark? E rond...ne ashtu thoshin n’katund t’jon. Pri t’jujave... oj nuse a e kie nusen e rond? Ashtu ishte llafi.”¹³.

Ndër emërtimet e kësaj fushe tematike është edhe *gjergunicë* për lehonë. Edhe leksema *gjergunicë*, sinonimike me *leonka/leusa/* (lehonë) nuk është pjesë e fondit leksikor të shqipes; *gjergunicë*, me *bj>gj*, nga *bjergunicë* <*bjer*> (Murati 2015, 86). Mirëpo, interpretimi, lidhur me leksemën *gjergunicë* nga Nopça dhe Doda është se “vjen nga fjala dirgjem, grua që dirgjej në shtrat” (Doda dhe Nopcsa 2015, 31).

2. 3. Leksema të dasmës

Në aspekte të ndryshme të dasmës nuk ka shumë dallime në zakone, në rite apo në emërtime në mes ortodoksëve dhe myslimanëve. Shumë nga leksemat janë të prejardhura dhe të formuara me ndajshitim. Përdorin emërtimin shqip *shkues*, por përdoret edhe leksema sllave *strojnik*. Po ashtu edhe: *përcjellsb* nga “përcjellë”, *petkaxhit*, *petkarët*, *petkallar* nga “petka”¹⁴. Në të njëjtën mënyrë formohet edhe leksema *druarët*, që shënon njerëzit që sjellin dru për të ndihmuar dasmorin: “Shkojn e dru bijn ka mali... druarët.”¹⁵, Apo edhe *hunazgjit* (unazxhi), grupi i meshkujve që janë caktuar me këtë detyrë: “Ndër kohë, të gjithë burrat e grishur (të ftuar) bëjnë përgatitjet e

¹³ Intervistë me Lepa Mlladenovska Spasenovskën, e lindur më 1933 në fshatin Nistrovë – Rekë e Epërme.

¹⁴ Petar Skoku, fjalët *petka* dhe *brez*, i jep si iliro-trakase (Skok 1978, 101).

¹⁵ Intervistë me Avdyll Halilin (1955-2015) në fshatin Patishkë – Karshiakë. Intervistë e realizuar më 28.01.2012. Intervista u realizua nga Ibe Mustafa dhe Bukurie Mustafa.

fundit për të dërguar *hunožen* (dhuratat e përgatitura nga familja e dhëndrit) tek familja e nuses” (Doda dhe Nopcsa 2015, 40). Asnjëra nga këto leksema nuk është pjesë e fjalorëve të gjuhës shqipe. Kjo tregon se gjuha popullore është konservative dhe i ruan shumë mirë ritet dhe emërtimet, duke përdorur prapashtesat dhe duke krijuar kuptime të tjera, të cilat kryesisht janë në numrin shumës. Kjo, në mënyrë simbolike, tregon edhe për kuptimin përmbledhës të organizimit të dasmës Studiuesi Petar Skok-u, për shumë nga ritet dhe leksematikën e dasmës, thotë se shprehjet e dasmës (*dars(z)ma*, *kraushk*), si edhe shprehjet e farefisnisë janë kryesisht joslave, por regjistron edhe leksemën *strojnik* që është sllave, të cilën e gjen në një fshat tjetër në rrethinë të Shkupit (Jabollcë), që është, po ashtu, me origjinë nga Reka.¹⁶ Këtu paraqitet dualizmi i leksemave sllave dhe shqipe. Leksema *krushk/ krushq*, përveç dallimit të kategorisë së numrit njëjës e shumës, ka edhe ndryshime në kuptim. *Krushk* përdoret për “mikun”, përkatësisht për prindërit dhe familjen e nuses. Ndërkaq, *krushq* përdoret në kuptim të njerëzve që shkojnë të marrin nusen. Sipas zakonit, në krye të krushqve prin një i ri, i cili mban bajrakun (flamurin): “*Bajrakut i ven peshkër... një moll dhe i ven pare...*”¹⁷.

Rrethanat historike-shoqërore diktojnë edhe përdorimin e disa emërtimeve, që nuk njihen në fjalor, por që i gjejmë në të folmen e Patishkës (si e folme rekase) dhe te një pjesë e mirë e shqiptarëve të anës së Karshiakës. Kështu, leksemën *çausb* e përdorin për njeriun, i cili mban rendin e dasmorëve dhe i prin krushqve. Nuk e dimë si qëndron kjo detyrë te rekasi, sepse nuk e gjejmë, së paku në pjesën myslimane, por për një grua ortodokse të Rekës së Epërme ky term ishte i njohur. Emërtimi *çausb*, në fjalorët e shumtë, ashtu si në fjalorët e gjuhës shqipe, përkufizohet si historizëm ballkanik, në kuptim “rreshter” dhe nuk njeh një përdorim tjetër,

¹⁶ Petar Skoku nuk ka të drejtë kur leksemën sinonimike për shkuesin, *misiti*, e jep me prejardhje greke. Në kuptimin e fjalës *misiti/msit*, fjala mbi të cilën ndërtohet kjo leksemë është parafjala “mes”, nga e cila dalin edhe: *mesiti/mesës/mesitni/mestari* që vjen nga kuptimi i ndërmjetësitë dhe hyn në fjalorin e fjalëve të vjetra të etnografisë (Shih: Skok 1978, 101).

¹⁷ Intervistë me Lepa Mlladenovska Spasenvoskën, e lindur më 1933 në fshatin Nistrovë – Rekë e Epërme.

megjithatë, po kjo leksemë, në të folmen popullore ka përfituar një kuptim të ri. Petar Skok-u, në librin *Etimologijski rječnik hrvatskoga ili srpskoga jezika* (1971), vëren bartje kuptimore të së njëjtës fjalë *čauš* në terminologjinë dasmore të gjuhës kroate a serbe, që arrin deri në Bosnje. Po i njëjti kuptim, në fjalorët e ndryshëm të gjuhës shqipe nuk është i regjistruar, mirëpo për gjuhën popullore, përkatësisht në disa të folme, ky emërtim në kuptim “krushkaparë” është i njohur mirë.¹⁸

Urimet e dasmës janë të njëjta dhe mjaft të përdorura: *Për hajr ta kesh dazmën! Hajr paç! Ngjefshi edhe ju!*

2. 4. Leksema të riteve mortore

Dallim të theksuar ka në fushën tematike të vdekjes, duke marrë parasysh që pjesa ortodokse e popullatës përdor shprehje më të veçanta, që kanë të bëjnë me religjionin e tyre. Më saktësisht, është një formë më e vjetër gjuhësore, që rrallë dëgjohet. Lepa Spasenovska, e intervistuar jonë, thotë:

“Na i thomi kur t’vdese për shyp...**N’derzhoje o Zat** si ka vdek. Ashtu i thoshin n’katund da vinte strina (sllav.) jeme o Lep ka vdek baba yt... **E ndërzhoje Zat**... Neka se najde na toj vek so nekogo (sllav.)... **Ndërzhoje Zat**

Pyejtes sime se nga i bie kjo Spasenovska i përgjigjet: “Don t’thon Bog da ja prosti (sllav.)...**nderja Zat**...ka vdek nona jote...**aj nderzhoje Zat**. Neka i e lesna zemja (sllav.). Trolli leht. Le ta ket trollin e leht.”

¹⁸ Është vështirë për të konkretizuar kohën e bartjes të kuptimit etnografik dhe përdorimit të këtij emërtimi, sepse edhe turqishtja nuk e njeh këtë kuptim, porse ajo ka depërtuar në kuptimet “nënoficer” a “ushtarak” dhe si e këtillë ka depërtuar edhe në gjuhët tjera. Në kuptim të “krushkaparit” nuk e ka as bullgarishtja e as maqedonishtja. Ekziston mundësia që të ketë ndryshuar kuptimin më vonë, por se si është përhapur kjo në gjuhën popullore dhe deri ku ka arritur si e tillë mund të mbështetemi vetëm në të dhëna terreni. Në disa të folmet shqipe të Maqedonisë (Shkup, Strugë, Kërçovë etj.), është i përhapur ky emërtim me po këtë kuptim; *çausb*- njeri që vendos rendin e krushqve dhe u prinë atyre.

Leksema është arkaike dhe është shumë e ngjashme me atë që e përdorin arbëreshët: “Në të folmet arbëreshe të Italisë, që janë kryesisht të besimit ortodoks të rritit grek, përdoret edhe ndjezoti ose ndëllezoti, që do të thotë ai që e ndjeftë zoti.” (Shkurtaç 2018, 240).

Koncepti mbi vdekjen është i përbashkët. E gjejmë edhe në Patishkë në këtë të folme, sepse vdekja konceptohet si “pushim”. (Mustafa 2017) E intervistuar, Lepa Spasenovska shprehet:

“Le t’pushojne açe te ka shku. Le t’pushoje mir. Un kisha njo ka katundi ka vdek... Kur shkutem... nie poveçe shiptarski (sllav.) E Rumena e shkret ka vdek. Koskat bosulek t’i mbin... E mir ka qon nuk ka qon e lig. Mir ka qon mir e gjetka... Nuk i greshitka (sllav.) askujt; Nderzhoje Zat ka pushut... I tollko (sllav.) thomi na... Ashtu thomi na. Ka pushut, ka vdek.”

Shprehja “koskat bosulek t’i mbin” ka të bëjë me besimin ortodoks, në të cilin ujin e borzilokut e quajnë “ujët e bekuar” dhe përdoret në shërbime të ndryshme nga kisha ortodokse. Një shprehje të ngjashme nuk e dëgjojmë te pjesa myslimane, te të cilët zhvillohen rite të varrimit sipas përkatësisë fetare myslimane, ku mbizotërojnë shprehje ngushëllimi si: “*t’ini ju shendosh*” (të jeni shëndoshë), “*mas mërzi*” (mos mërziteni), “*gajret burra*” etj. (Doda dhe Nopcsa 2015, 52).

Ndasitë fetare kanë ndikuar thellë në vetëdijen e këtyre banorëve, të cilët deklarohen si ortodoksë maqedonas, mirëpo e folmja e tyre është shqipe e pastër. E intervistuar jonë, në një rast thotë: “Si t’i shkrujne Perëndia thomi na makedonski, ju i thoni Allahu.” Leksemat në këtë rast zbulojnë edhe botëkuptimin e saj se *Perëndi* qenka “makedonski” (maqedonisht), por e mendon në aspektin fetar ortodoks e *Allahu* i përket myslimanëve dhe se këta janë shqiptarë.

2. 5. Leksema etnografike *nún* dhe *nuní-a*

Leksema të etnokulturës janë edhe *nún* e *nuní*, të cilat i gjejmë më të përhapura te popullata ortodokse dhe më pak janë ruajtur te myslimanët. Te pjesa myslimane e ruajnë te ceremonia martesore (në Patishkë quhet shoqëruesi i dhëndrit). Kjo lidhje llogaritet si e shenjtë dhe ka raste kur *nuní* vendoset mes një myslimani dhe një ortodoksi. Ortodoksët e shtrijnë

kuptimin e kësaj lidhjeje, pasi përdoret në kuptim të atij që ia vë emrin fëmijës dhe për këtë *keka Lepë*¹⁹ shprehet: “Núni ja ve emnin. Edhe athere edhe tashti ala ashtu osht...nuni ta vure emnin... Athere s’kishte... Si t’vine nuni jep emën si mo t’vije nuni s’ka emën. Ajo si ka qon e ka pagzut gjalín”.

Pyetjes sonë nëse nuni i pret flokët dhe çka bëhet me to, Spasenoska i përgjigjet: “I ruejn a i fjugen.” Ndërsa sa i takon thonjve, ajo vëren: “Nuni... te ne ashtu nuni i pret thoit...n’kish qi t’i pagezojn. Ja nuni ja se popi. Nuni ja preste. U japin dar (sllav.) atyve.”

Lidhjen me nunin e intervistuar e quan shumë të fortë, si më të afërmin e familjes dhe me të nuk duhet të lidhet martesë, sepse, si thotë ajo, është “gjynah”. “Osht gjyna, as japim as marrim. Nuní osht ma i afërti i familjes”. Ka pasur raste kur ka ndodhur martesa mes tyre, por që janë tepër të rralla.

2.6. Leksema të gatesave në rite

Fusha tematike e etnokulturës është edhe më e gjerë në aspekt të riteve, që gjenden edhe te popujt e tjerë ballkanas. Mund të marrim si shembull vendosjen e lekut (pares) brenda bukës gjatë festave të kalendarit popullor.²⁰ Te popullata myslimane kjo ka mbetur vetëm në rite të dasmës. Gjatë këtij riti, vajzën që zë brumin e kulaçit e quajnë *kulaçtorja/kulaçtorja*, (nga “kulaç”-kulaçtore), që është e mbarë shqipes. Lepa Spasenovska tregon se ky zakon gjendet edhe tek ortodoksët: “Kolaç t’enjten e bonjin. Nusja e dhondri nuk shiheshin.”²¹ Në të folmen e Rekës, Nopcsa dhe Doda japin

¹⁹ *Keka*, në këtë të folme përdoret në kuptim “teze” a “hallë” dhe është një formë respekti kur i drejtohem një gruaje në moshë.

²⁰ “Buka me pare”, sipas Ana A. Plotnikovës, në kuadër të etnokulturës sllave jepet si ballkanike dhe ballkanosllave dhe përdorimin e saj e sheh në leksemat e përdorura në territorin më të gjerë të arealit lindor-serb dhe perëndimor-bullgar dhe maqedonase. ПЛОТНИКОВА Ана А, ЕТНОЛИНГВИСТИЧКА ПРОГРАМА ВО МАКЕДОНСКИОТ ПУНКТ НА „МАЛИОТ ДИЈАЛЕКТОЛОШКИ АТЛАС НА БАЛКАНСКИТЕ ЈАЗИЦИ”, www.iea.pmf.ukim.edu.mk/EAZ/EAZ-oo/Plotnikovamak-EAZ-oo.pdf, 29.6.2016.

²¹ *Kulaç m.* “bukë e ngjeshur e rrumbullakët”. Fjalë e mbarë shqipes duke përfshirë edhe Arbëreshët e Italisë e Greqisë. Huazim prej sll. (skr.) *koláč*, (bullg.) *koláč*. Geg.

një kuptim tjetër të *kalaçit/kaleçar*: “Përafërsisht, një dy javë pas dasme, vijon vizita e ndërsjellë e dy familjeve të miqësura të krushqisë (familjes së dhëndrit e nuses). Kjo vizitë (vizita e parë) është pagëzuar sipas një lloj gurabije prej miellit të bardhë që quhet kalaç, shkuen n’kalaç, ose erdhën n’kalaç, gjersa mysafirët pjesëmarrës, quheshin *kaleçar*” (Doda dhe Nopcsa 2015, 49).

Edhe ushqimet e përgatitura për festa të veçanta të kalendarit popullor, apo ato që kanë të bëjnë me gatesa të veçanta marrin një kuptim etnografik. Një ndër gatesat, që e gjejmë te rekasi është *ndurdhi* (në Patishkë *ndërdhi*). Sipas Doda dhe Nopcsa, *ndurdhi* përgatitet në “ditën e lindjes, ose një ditë më vonë, po që se lindja bëheshe pasdite, shtrohej për drekë *ndurdhi*- një lloj byreku me peta të trasha. Ku pasi piqet copëtohet në grimca të vogla, që quhet *fli e copëtuar*.” (Doda dhe Nopcsa 2015, 31). Ndërkaq, në Patishkë i thonë *ndërdhi*, që është plotësisht gatesë e njëjtë dhe që copëtohet pasi piqet. Në të kaluarën e kanë përgatitur në ditën e Vasilicës (Shën Vasilit), duke vendosur një monedhë, para në *ndërdhi*. Gruaja e Rekës, Lepa Mlladenovska Spasenovska, tregon se në festën e Shën Vasilit, në Vasilicë, kanë përgatitur *fli*, të cilën nuk e copëtojnë, por e presin. Në të kanë vendosur një monedhë, e cila lidhet me parashikimin e fatit të atij që e gjen paranë dhe me parashikimin e motit.

Për dallim nga Patishka, rekasi për festën e Vasilicës përgatitet *fli*. Sipas Lepës: “Fli kemi botën. Fli bonjim me gjiz, me kas. Aty hanjim edhe kapërcenjim” Ajo shpjegon procesin e kësaj flije gjatë festës së Vasilicës dhe ritit: “Për Vasilic flija ishte; nuk e ndanjim na; na e bonjim dhe e prinjim me thik; një cop e vinjim me një gazet, me një kart, edhe e lom diku açe dhe do thomi ndonji arush da e hanje, da hanje flin... Arusha athere a da kite dimën a s’da kite dimën, si t’haje flinë... Ala zgjat dimni, si mos ta haje... L. S. *ala ka dimën...* zgjat. B. Mustafa: Por çfarë ndodhte në rrethana kur e gjen çika apo

veriore ka *kuleç* me ndërrimin dialektor -a-> -e- (khs. Tesh, nelt). Emri *kulaçe* për “topa brumi, që vihen një mbi një, shtypen e ngjishen si kulaç dhe tëhollen së bashku për të bërë petë lakrori” me formantin e emrave të gjinisë femërore dhe të shumësit të tyre duke qenë fjala shumës i singularizuar. Prej Arbëreshëve të Italisë ka depërtuar në dialektet italiane të Kalabrisë. Topalli, Kolec. 2017. *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë.

djali paren? Keka Lepë thotë: *...e ruejn ato se o sreç (sllav.)..., si t'kie a si mo'kie ...; çika da e rryne da martohet ...* e nëse i bie djalit *...edhe ai për kismet...* (Lepa Spasenovska, 1933, fshati Nistrovë)

Flinë e përshkruan qartë Hahn-i, i cili tregon përgatitjen e flisë (gatesë me vaj e miell e cila piqet shtatë ditë pas lindjes së një fëmije dhe e thërrmuar bashkë me pemë u shtrohet farefisit dhe miqve të shtëpisë. Këso ëmbëlsire gatuhet po ashtu edhe për ditëlindje të fëmijës) (Jokli 2017:250-251). Kjo tregon se të dhënat nga Hahn-i janë po të njëjtat që jep edhe Ismail Elmaz Doda. Po ashtu, Jokli thekson që përveç kuptimeve që i jep më sipër nuk janë të vetmet raste festimi për përgatitjen e kësaj gatese (Jokli 2017:251), që e shohim edhe me rastin e festimit të ashtuquajturës *Vasilicë* (Shën Vasili).

3. Përfundime

Patishka dhe regjioni i fshatrave të Rekës së Epërme janë treguesit më të mirë për një bashkëjetesë në mes dy religjioneve, të cilët, si pasojë e një sistemi, ndryshuan dhe u larguan nga njëri-tjetri. Mirëpo, jeta e përbashkët, festat e përbashkëta janë dëshmi për shumëkënd se ndasitë mes tyre nuk janë edhe aq të thella dhe se nuk kanë funksionuar në armiqësi, ashtu si paraqiten shqiptarët nga pjesa dërmuese e opinionit sllav. Këta mbijetuan falë zakoneve, riteve dhe gjuhës. Ndër të tjera, kjo konfirmohet edhe nga të intervistuarit në Patishkë ku shprehet njëtrajtësia: “kemi pas një gjuhë, një mvësh e tjetër fe”²². Ky element i vetëm i dallimit mes banorëve të këtyre vendeve, feja, ishte mjaft e fuqishme dhe ka kaluar nëpër një proces të gjatë, duke marrë parasysh se ka dëshmi nga vetë hulumtuesit serbë të shekullit të kaluar, të cilët tregojnë për jetën fetare dhe lutjet paralele, që prifti lexonte në gjuhën sllave dhe përsëritja nga besimtarët ortodoksë, mirëpo është interesant vazhdimi i lutjes në gjuhën shqipe, sepse ata e dinin përmendsh (Филиповић 1931:172).

Leksemat e etnokulturës janë ndër fjalët më të qëndrueshme në përdorim dhe këto janë të gjalla vetëm brenda përdorimit të një të folmeje,

²² Intervistë me Avdyll Halilin (1955-2015) në fshatin Patishkë – Karshiakë. Intervistë e realizuar më 28.01.2012. Intervista u realizua nga Ibe Mustafa dhe Bukurie Mustafa.

vetëm në ligjërimin popullor. Sipas përkufizimit të Majkëll Alan Park-ut, fjalët dhe kategoritë e fjalëve vendosen në një lidhje intime me mjedisin jetësor, shikimin mbi botën dhe sistemin kulturor të shoqërisë që e përdor gjuhën (Park 2012, 297), gjë që supozon se ndryshimi i këtyre faktorëve do të sjellë deri në humbjen e zhdukjen e këtij thesari, sa gjuhësor, po aq edhe kulturor. Sa për ilustrim, Nopça dhe Doda japin emërtimin *fyrta*, që tregon nënën e gjirit (Doda dhe Nopcsa 2015, 29), por ky zakon i gjidhënies nga një grua tjetër nuk është më i gjallë, gjë që bën që edhe leksema, si e tillë, të kalojë te leksemat e vjetruara²³.

Leksemat e etnokulturës, të trajtuara në shumë anë kuptimore, bëhen burim informacionesh jo vetëm semantike e leksikore, por e shtrijnë informacionin edhe në sferë të etnologjisë dhe bëhen treguesit kyç për shumë çështje, që krijojnë probleme kur ato vendosen në një kontekst më të gjerë, mbase edhe ballkanik. Bëhet fjalë për ngjasime, jo vetëm gjuhësore, të cilat me një emër i quajmë *gjuhësi ballkanike*, por edhe të shtrirjes në ngjasimet në aspekt të leksikut kulturor, të cilat të vendosura në një rrafsh krahasimtar, ndihmon për zhvillimin e gjithmbarshëm të trajtesës etnologjike dhe të leksematikës, pa qëllimin e përvetësimit të riteve e zakoneve me idenë e interpretimit se të kujt janë apo prej kujt janë marrë, që duhet ndryshuar duke pasur për synim një vështrim më të shtrirë e më përmbajtjesor e për të kuptuar kulturën e një populli, e në këtë rast të shqiptarëve brenda arealit ballkanik.

Burimet e përdorura:

1. Intervistë me Lepa Mlladenovska Spasenovskën, e lindur më 1933 në fshatin Nistrovë – Rekë e Epërme. Intervistat janë realizuar më 18.02.2012 dhe 14.05.2016 nga Ibe Mustafa dhe Bukuriye Mustafa, Shkup.

²³ “Kjo nënë, që përkohësisht ushqen me gji foshnjën e porsalindur, quhet *fyrta*. Nëna e gjirit (qumështit), llogaritet për tërë jetën, si nëna e dytë e foshnjës. Nëse rrethanat janë të tilla, që foshnja e porsalindur qumështin e parë e pinë nga *fyrta* (nëna e qumështit), atëherë nëna e foshnjës i ofron asaj një dhuratë të vogël”. Franz Nopcsa & Bajazid Doda, Jeta e fshatarëve shqiptarë në grykën e Rekës së Epërme, 2015, 31.

2. Intervistë me Avdyl Halilin (1955-2015) në fshatin Patishkë – Karshiakë. Intervista është realizuar më 28.01.2012 nga Ibe Mustafa dhe Bukuriye Mustafa.



Foto 1. Lepa Spasenovska (në mes) me veshje nusërie, në fshatin Nistrovë të Rekës së Epërme (mesi i viteve '50 të shek. XX). Fotografi nga koleksioni personal i Lepa Spasenovskës.



Foto 2. Shtëpi në fshatin Nistrovë, fotografuar gjatë hulumtimit në Rekë të Epërme (06.05.2018). Foto: Bukuriye Mustafa.



Foto 3. Nga manifestimi “Takimet e Rekës së Epërme 2019” mbajtur në fshatin Rimnicë, organizuar nga Shoqata për Kulturë “Reka e Epërme”-Gostivar. Foto: Bukuriye Mustafa.

Bibliografi

- Alan Park, Majkëll. 2012. *Hyrje në antropologji*. Shkup: Projekt i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë “Përkthim i 1000 librave profesionalë dhe shkencorë”.
- Doda, Bajazid E. në bashkëpunim me Franz Baron Nopcsa. 2015. *Jeta e fshatarëve shqiptarë në grykën e Rekës së Epërme, Dibra e Madhe (Maqedoni)*, shqipëruar nga Nexhat Mehmedi dhe Ismail Murati. Koçani: Evropa 92
- Elsie, Robert. “Tabllo e një jete të zhdukur”, *Shkoder.net*, konsultuar për herë të fundit më 13 tetor 2020,
<https://shkoder.net/fjala/2007/relsie.htm>
- Jokli, Norbert. 2017. *Studime historiko-krabasuese për gjuhën shqipe, “Historisch vergleichende Untersuchungen über das Albanische”*. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.
- Murati, Qemal. 2015. *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni*. Shkup: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve.
- Mustafa, Bukuriye. 2017. “The Ethno-Linguistic Aspects of the Birth and the Death Rituals in Balkan Linguistics Context”. *Vakanivis-Uluslararası Tarih Araştırmaları Dergisi*, 2 – 1: 32-45
- Mustafa, Bukuriye. 2018. *Patishka-vëzhgime gjuhësore dhe etnokulturore*. Shkup: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve.
- Nagórko, Alicja. 2004. “Etnolingvistika i kulturemi u međujezičnom prostoru”, *Rasprave Instituta za hrvatski jezik i jezikoslovlje*, 30: 131–143
- Nopcsa Franc. 2012. *Pikëpamjet fetare, doket dhe zakonet e Malcisë së Madhe*. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë.
- Sinani, Idaete. 2019. “Fonemat e bashkëtingëlloreve në të folmen shqipe të fshatrave me prejardhje nga Reka e Epërme”. *Studime albanologjike*, Shkup, 19: 52-68.
- Sinani, Idaete. 2020. “Disa tipare të veçanta të së folmes së Rekës së Epërme.” *Studime albanologjike*, Shkup 20: 74-88.
- Skok, Petar. 1971. *Etimologjski rječnik hrvatskoga ili srpskoga jezika*. Zagreb: Jugoslovenska Akademija Znanosti i Umjetnosti.

- Skok, Petar. 1978. "Hulumtime gjuhësore te popullsitë joslave të luginës së Shkupit". *Studime gjuhësore*, Instituti Albanologjik i Prishtinës. Prishtinë (I): 81-103.
- Shkurtaç, Gjovalin. 2018. *Etnografia e të folurit të shqipes*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Tirta, Mark. 2007. *Panteoni e simbolika – doke e kode në etnokulturën shqiptare*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Topalli, Kolec. 2017. *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Ymeri, Haki. 1998. *E folmja e Karshiakës*. Shkup: "Shkupi".
- Плотникова, А. Ана. "Етнолингвистичка програма во македонскиот пункт на Малиот дијалектолошки атлас на балканските јазици, www.iea.pmf.ukim.edu.mk/EAZ/EAZ-00/Plotnikovamak-EAZ-00.Pdf, konsultuar për herë të fundit më 13 mars 2020
- Смиљанић, Тома. 1925. *Населба и порекло становишта*, „Мијаџи, Горна Река и Мавроско Поље". Српски Етнографски Зборник, књ. XXXV. Српска Краљевска Академија. Београд: 7-674.
- Трифуноски, Јован. 1958. *Слив Маркове Реке-антропогеографска проматрања*, кн. 7. Скопје: Филозофски Факултет на Универзитетот.
- Филиповић С., Миленко. 1931. *Патишка*, Јужни преглед, бр. 4, Скопје: 163-174.
- Филиповић С., Миленко. 1939. Обичаја и веровања у Скопској котлини, Српски етнографски зборник, књ. LIV, Живот и обичаји народни, књ. 24, Београд: 277-564.